



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:077276
Datë: 27.04.2021
Numri i dokumentit: 01733926

C.nr.1/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, gjyqtari Venhar Salihu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. H. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim Elmi Qerimi avokat nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurve V. H. nga Gjilani, Rr.”.....”, nr.56 dhe SH. T. “D&A CONSTRUCTION” sh.p.k. me seli në Prishtinë, Rr.”Preoce”,pn, lidhur me çështjen juridike kontestimore, anulimin e kontratës mbi shitblerjën, jasht seancës më dt.26.04.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Padia e paditëses V. H. nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurve V. H. nga Gjilani, dhe SH. T. “D&A CONSTRUCTION” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, anulimin e kontratës mbi shitblerjën, **KONSIDEROHET SI E TËRHEQUR.**
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m i

Paditësja V. H. në këtë gjykatë ka paraqitur padi me datë 18.12.2017, kundër të paditurve V. H. nga Gjilani, dhe SH. T. “D&A CONSTRUCTION” sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike kontestimore anulimin e kontratës mbi shitblerjën.

Në lidhje me këtë çështje gjykata ka caktuar shqyrtim përgatitor për datë 26.04.2021 me fillim në ora 10:30, ku palëve ndërgjyqëse gjykata i ka dërguar ftesë, por ftesën për këtë seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt i autorizuari i paditëses, por i njejt nuk ka prezentuar dhe mungesen e tij nuk e ka arsyetuar.

Sa i përket faktit të pranimit të ftesës në mënyrë të rregullt nga ana e av. Elmi Qerimi, gjykata ka vërtetuar nga fletkthesa e cila gjindet në shkresat e lëndës.

Me që në rastin konkret paditësja, përkatësisht i autorizuari i saj është ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën e tij nuk e ka arsyetuar dhe në të njëjtën kohë, gjykata nuk ka pasur ndonjë kërkesë për shtyrjen e seancës se lartëcekur, erdhi në përfundim se padia e

paditëses duhet të konsiderohet si e tërhequr edhe atë duke u bazuar në nenin 409.1 të LPK-së dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Sa i përket pëlqimit nga ana e të paditurve edhe atë bazuar në nenin 261.2 të LPK-së, gjykata nuk i dërgoi pasi që të njejtëve nuk ka qenë e mundur që ti dorzohet padia me prova dhe aktvendimi për përgjigje në padi ¹.

Prandaj, nga të lartëcekurat dhe bazuar në nenin 387.1 nën pika c) dhe nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së lidhur, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1/18, dt.26.04.2021

Gjyqtari,
Venhar SALIHU

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

¹ Për shkak se i padituri i parë jeton në Zvicër, kurse i padituri i dytë adresa ka qenë jo e plotë.